

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Beqir Kalludra, kryetar, dhe gjyqtarët profesionistë Albina Rama dhe Arben Hoti, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Mybera Latifi, në çështjen penale kundër të akuzuarve M. G. dhe A. G., për shkak të veprave penale, secili veç e veç, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së dhe kundër të akuzuarit M. G. edhe për veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PP/L.nr.536-1/11 të dt.23.10.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në të cilën kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Hivzi Bajraktari, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, av.B. A. dhe av.G. A., që të dytë sipas detyrës zyrtare, me dt.05.11.2015 mori, dhe të njëjtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

M. G., i biri i L. dhe M., e gjinisë D., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin B., komuna e L., ku edhe tani jeton, i martuar, babë i 7 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion bujk, invalid, i gjendjes së dobët ekonomike, i padënuar më parë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim prej dt.26.07.2011 deri më 23.09.2011, ndërsa në arrest shtëpiak prej dt.23.09.2011 deri më 23.10.2011.me nr.personal *numri personal...*

A. G., i biri i M. dhe A., e gjinisë G., i lindur më *data e lindjes...*, në P., tani me banim të përhershëm në fshatin B., komuna e L., ku edhe jeton, i martuar, babë i një fëmije, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, i padënuar më parë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim prej dt.26.07.2011 deri më dt.23.09.2011, ndërsa në arrest shtëpiak prej dt.23.09.2011 deri më 23.10.2011. me nr.personal *numri personal...*

JANË FAJTORË

Sepse

I akuzuari M. G.

-me dt.26.07.2011, rreth orës 15.00, në fshatin B., komuna e L., në afërsi të shtëpisë së tij dhe të dëmtuarit F. G., me qëllim të frikësimit të të dëmtuarit, i akuzuari i është kërcënuar duke përdorë pushkën automatike AK-47 me nr.serik034831-86 në pronën e tij në atë mënyrë që për shkak të një zënke në mes tij dhe të dëmtuarit, pasi që në të njëjtën ditë ishte përfshirë nga zjarri shtalla e ushqimit të bagëtive të të akuzuarve M. dhe A. G., e të cilët dyshonin se këtë akt e kishte kryer i akuzuari F., dhe i akuzuari M. e fyen dhe e shan të dëmtuarin F., më pas ia merr armën bashkëshortes së vet të cilën më parë dëshmitari Sh. G. ia kishte marrë nga dora të akuzuarit A. dhe të njëjtin ia kishte dhënë asaj, ashtu që

i akuzuari M. niset në drejtim të të dëmtuarit F., në atë moment ndërhyt dëshmitari Sh. G., i cili tenton që t'ia largojë armën nga dora, mirëpo i akuzuari nuk e lëshon dhe shtien me të njëjtën në ajër derisa e zbrazë tërë karikatorin ku më pas dëshmitari Sh. G. ia heq armën nga dora dhe e hudh disa metra larg vendit të ngjarjes, e të cilin pasi arrinë policia në vendin e ngjarjes e sekuestrojnë.

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së

I akuzuari M. G.

2.me datë, kohë dhe vend të përshkruar si në dispozitivin e parë, në vendin ku kanë qenë një numër i madh i personave, anëtarët e familjes së tij dhe të të dëmtuarit F. G., ka shtënë me pushkën automatike AK-47, me nr.serik034831-86, me çka ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e tyre.

-me këtë ka kryer veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së

I akuzuari A. G.

-me dt.26.07.2011, rreth orës 15.00, në fshatin B., komuna e L., në afërsit të shtëpisë së tij dhe të dëmtuarit F. G., në mënyrë kërcënuese me qëllim të frikësimit, ka përdorur pushkën automatike AK-47, me nr.serik034831, prone e tij, ashtu që për shkak të një zënke në mes të tij dhe të dëmtuarit F. G., pasi që në të njëjtën ditë ishte përfshirë nga zjarri shtalla e ushqimit të bagëtive e të pandehurve të lartcekur, të cilët dyshonin se këtë akt e kishte kryer i dëmtuari F., i pandehuri A. e merr armën e lartcekur, e cila ka qenë në vendin e pidentifikuar deri më tani, pastaj ia drejton të dëmtuarit F. dhe i kërcënohet me fjalët 'ik largohu nga këtu se po të vras', mirëpo në atë moment ndërhyt dëshmitari Sh. G. dhe ia hjek armën nga dora dhe të njëjtën ua jep familjarëve të të pandehurit A..

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 3, 34,39, 40,43,60, 64, 291 dhe 328 të KPK-së, si dhe nenet 359, 365, 450, 453 dhe 463 të KPK, i

G J Y K O N

Të akuzuarin **M. G.** për veprën penale nën pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi e dënon **ME DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 1200 (njëmijëedyqind) euro, nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën e shqiptuar e njejta do të shndërrohet në dënim me burgim duke ia llogaritur për çdo ditë burgim 20 euro të gjobës me kusht që afati i burgimit të mos kalojë afatin 6 muaj.

- për pikën 2 të dispozitivit të aktgjykimit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 2 (dy) vjet nuk kryen vepër tjetër penale, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.26.07.2011 deri më dt.23.09.2011, si dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak prej dt.23.09.2011 deri me dt.23.10.2011.

Të akuzuarin **A. G.** për pikën 3 të dispozitivit të këtij aktgjykimi e gjykon me **DËNIM ME KUSHT** në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 2 (dy) vjet nuk kryen vepër tjetër penale, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej dt.26.07.2011 deri më dt.23.09.2011, si dhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak prej dt.23.09.2011 deri me dt.23.10.2011.

Detyrohen të akuzuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërkaq në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 100 (njëqind) euro, secili veç e veç, të cilën duhet të paguajnë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarve iu konfiskohet pushka automatike AK-47 me nr.serik034831-86, si mjete me të cilat është kryer vepra penale.

Të dëmtuarit F. G., Sh. G., M. G.1 dhe P. G., nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore-juridike.

Kundër të akuzuarve M. G. dhe A. G. konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPRK-së

REFUZOHET AKUZA

Sepse

I akuzuari **M. G.** që nga periudha kohore e pavërtetuar e deri me datë, kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në pikën 1 të këtij aktgjykimi pa leje valide të organit kompetent për mbajtje të autorizuar të armëve, ka mbajtur në pronësi pushkën automatike të markës AK-47 me nr.serik034831-86 të cilën e ka përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

--me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së

Sepse

I akuzuari **A. G.** që nga periudha kohore e pavërtetuar e deri me datë, kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në pikën 1 të këtij aktgjykimi pa leje valide të organit kompetent për mbajtje të autorizuar të armëve, ka mbajtur në pronësi pushkën automatike të markës AK-47 me nr.serik034831-86 të cilën e ka përdorur me rastin e kryerjes së veprës penale si në pikën 3 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

--me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së

A r s y e t i m

Prokuroria e Qarkut në Prishtinë ka paraqitur aktakuzë PPNr.536-1/11 të dt.07.09.2012 kundër të akuzuarve M. G. dhe A. G., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par.1 nënpar.4 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, dhe secili veç e veç për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, të akuzuarit kanë deklaruar se nuk e pranojnë fajësinë për veprat penale të cilat iu vihen në barrë. Meqë të akuzuarit nuk e kanë pranuar kryerjen e këtyre veprave penale, Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me prezantimin e provave.

Prokurori i shtetit pas përfundimit të procedurës së provave në fjalën përfundimtare ka bërë ricilësimin e këtyre veprave penale dhe atë se tani i akuzuari M. G. akuzohet për veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm dhe që të dytë të akuzuarit akuzohen për veprat penale secili veç e veç Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, dhe Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, dhe duke pas për bazë faktin se vepra penale nga neni 328 par.2 të KPK-së në kohën e kryerjes është e përfshirë në ligjin mbi amnistinë, është tërëhjekur nga ndjekja penale kundër të dy të akuzuarve për veprën penale nga neni 328 par.2 të KPK-së. Ndërkaq për veprat tjera ka ngelë në tërësi pranë aktakuzës së ndryshuar dhe cilësimit juridik për këto vepra penale duke shtuar se me provat e proceduara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar pa mëdyshje fakti se të akuzuarit M. G. dhe A. G. i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar, duke i propozuar gjykatës që për këto vepra të njëjtit të shpallen fajtorë dhe të gjykohen sipas ligjit.

I akuzuari M. G. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në ditën kritike ka shtënë me armë –pushkë automatike dhe ate në ajër me armën të cilën ia ka lënë amanet prindi i tij, e cila armë ka qenë e vendosur në shtallë dhe i njëjti ka shkuar për ta marrë nga frika se mos po digjet dhe po shkakton dëme edhe më të mëdha nga eksplodimi i barotit dhe fishekët dhe se qëllimi i të shtënave ka qenë që të alarmohet rrethi se të njëjtit i është djegur shtalla e bagëtive ku i njëjti ka pësuar dëme të mëdha materiale për të cilën veprim është penduar thellë dhe se me tani të dëmtuarit marrëdhëniet i kanë shumë të mira. Ndërkaq i akuzuari ka ndryshuar deklaratën nga ato të dhëna në polici, dhe tani është arsyetuar se me rastin e dhënies së atyre deklaratave ka qenë shumë i shqetësuar për shkak të demit që ka pësuar dhe se edhe pa vetëdije mund të ketë deklaruar ashtu. Po ashtu ka shtuar se distanca mes tyre dhe të dëmtuarëve ka qenë shumë e afërt 4-5 metra dhe se edhe dyshimet që i ka pas në tani të dëmtuarin F. tani deklaroi se mund të kem dyshuar në të duke qenë tepër i shqetësuar për dëmin e shkaktuar dhe se vërtetë nuk e di as vetë çka kanë thënë, mirëpo i njëjti e ka mohuar faktin se armën e ka sjell nga shtëpia A..

Mbrojtësi i të akuzuarit M. G. av-B. A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: me provat e proceduara gjatë këtyre seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i mbrojturi im ka kryer veprat penale tani të ricilësuar duke mos e kontestuar faktin se i akuzuari M. G. pushkën automatike të markës AK-47 e ka poseduar në pronësi-posedim dhe se me të njëjtën ka shtënë disa here në ajër për ta alarmuar rastin e ndodhur e duke pas për qëllim që të dëgjohet në rrethin dhe ti ofrohet ndihmë nga të tjerët për fikjen e

zjarrit. Po ashtu edhe nga dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve është vërtetuar fakti se i njejti ka shkrepë-shtënë me armë dhe se në momentin e shtënies ka pasur shumë persona-anëtarë të të dy familjeve, duke shtuar më tutje se marrëdhëniet mes këtyre dy familjeve kanë qenë gjithmonë të mira. Ashtu që duke pas për bazë faktin se i akuzuari është invalid i kategorisë së parë –lëvizë vetëm me ndihmë ortopedike, ashtu që me rastin e vringëllimës së armës, të pranishmit janë kujdesë që me rastin e të shtënave në ajër, tyta e armës të jetë në pozitë sa më vertikale, ashtu që të mos vie deri te ndonjë eksces nga vringëllima e armës. Andaj duke pas për bazë këtë gjendje të fakteve i propozon gjykatës që konform nenit 364 par.3 të KPPRK-së në mungesë të provave të merr aktgjykim lirues.

I akuzuari A. G. në seancën e shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje ndërkaq në Prokurori me rastin e dhënies së deklaratës në presence të mbrojtëses së tij sipas detyrës zyrtare av.V. M.-B. i njejti ndër të tjera ka deklaruar se pas ngjarjes që ka ndodhur i dëmtuari S. i është drejtuar me fjalët ti po na thua neve se ju i keni kall duke e shtyer dhe i thënë largohu prej këtuhit se po na ngjet fjalë neve dhe pastaj ka ndërhyrë tani i dëmtuari F. duke e goditur në krahë të majtë me grusht dhe pastaj djemtë e tij me shqelma dhe grushta, derisa i akuzuari A. ka kërkuar ndihmë nga babai i tij, i cili kishte marrë pushkën automatike në dorë dhe me te ka shtënë në ajër 3-4 herë në mënyrë që F. me S. dhe djemtë e tyre të largohen dhe të kthehen në shtëpitë e tyre duke mohuar në tërësi faktin se i njejti ka poseduar armë në dorë derisa në polici ka deklaruar se pas ndezjes së shtallës, kushëriri i tij F. dhe vëllezërve të tij ka lëvizur në afërsi të shtallës dhe babai i tij, tani i akuzuari M., ka kërkuar nga ata që të largohen derisa i njejti ka deklaruar se me automat ka shtënë Sh. dhe S. G..

I akuzuari A. G. në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas ricilësimit të veprës penale nga neni 328 par.1 të KPK-së i njejti është mbrojtur në heshtje, ndërkaq në deklaratat e tij të dhëna në Prokurori dhe polici i ka mohuar në tërësi kryerjen e veprave penale, për të cilat është akuzuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. G. av-G. A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se me provat e administruar nuk është vërtetuar se I akuzuari A. G. e ka përdorë armën, po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitarit F. G. vërtetohet fakti se A. G. nuk ka pasur armë dhe nuk ka shtënë me armë. Edhe dëshmitari Sh. G. ka dëshmuar se nuk ka pas i njejti armë ndërkaq dëshmitari M. G.1 nuk ka vërejt fare armë në vendin e ngjarjes. Andaj i propozon gjykatës që në mungesë të provave të merr aktgjykim lirues.

Të dëmtuarit F. G., Sh. G., M. G.1 dhe P. G. nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore-juridike.

Pas vlerësimit të provave të proceduara një nga një dhe të gjitha së bashku konform nenit 387 par.2 të KPPRK-së ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se me dt.26.07.2011 rreth ores 15.00, në fshatin B., komuna e L., pasi që paraprakisht iu është djegur shtalla-plemja e tani të akuzuarve M. dhe A. G.m, të njejtit fillimisht kanë dyshuar për vënien e zjarrit nga të afërmit e tyre tani të dëmtuarit F. G., Sh. G., M. G.1 dhe P. G., e të cilët duke mos pasur njohuri për dyshimin e të akuzuarve, pasi që e kanë vërejtur se shtalla e bagëtive është duke u djegur kanë shkuar për t'iu ndihmuar në shuarjen e zjarrit, ndërkaq të akuzuarit M. dhe A. G. duke qenë jashtëzakonisht të mllëfosur me pasojat e dëmit që do

të shkaktohet, fillimisht dëshirojnë të largojnë nga oborri i tyre të dëmtuarit, ku pastaj i akuzuari A. e merr armën e tipit AK-47 nga shtëpia dhe iu kanoset tani të dëmtuarve, me ç'rast gjatë kësaj kanosje, i dëmtuari Sh. arrinë t'ia largoi nga dora armën e lartcekur dhe të njejtën ua kthen familjarëve të tij, përkatësisht nënës së tij dhe pastaj duke vazhduar gjendja e tensionuar, i akuzuari M. ia merr armën bashkëshortes së tij dhe me qëllim të frikësimit të të dëmtuarve, i akuzuari M. nisët në drejtim të të dëmtuarit F. fillon të shtiej me armë në ajër, derisa e zbrazë tërë karikatorin, dhe pastaj dëshmitari Sh. G. ia tërhjek armën nga dora duke e hedhur disa metra larg vendit të ngjarjes, e të cilën armë pastaj policia e kanë sekuestruar.

Këtë gjendje faktike e ka vërtetuar nga të gjitha provat që janë proceduar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor duke filluar nga dëshmitë e dëshmitarëve-të dëmtuarve, provave material – fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes i dt.26.07.2011, procesverbali i dëshmisë së pronës të dt.26.07.2011.

Nga dëshmia e dëshmitarit F. G. vërtetohet fakti se pas shkakimit të zjarrit në shtallën e të akuzuarit M. i njëjti ka shkuar në vendin e ngjarjes me i ndihmuar për ta shuar zjarrin dhe njëherit është përpjekur që ta mbrojë shtallën e vet për mos me ardhë deri te ndezja eventuale e zjarrit ku aty kanë ardhë edhe anëtarët e dy familjeve tona, dhe pastaj fillimisht ka ardh i akuzuari A. me automat në dorë dhe na u është kanosur dhe i akuzuari M. e ka marr armën dhe ka shtënë me të njejtën mirëpo nuk ka shtënë në drejtim tonin, ku nga këto të shtëna nuk është dëmtuar askush dhe pas kësaj ngjarje asnjëherë nuk kemi pasur problem me M., ne jemi të një familje, andaj edhe nuk ka pas për qëllim që ta lëndoj askënd.

Po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitarit Sh. G. vërtetohet pakontestueshëm fakti se ditën kritike pas zjarrit të shkakuar në shtallën e bagëtive të të akuzuarve ka ardh deri te një mosmarrëveshje mes të dëmtuarve dhe të akuzuarve ku i njëjti ia ka hjekur nga dora automatikun të akuzuarit A. dhe të njejtin ia ka dorëzuar prindit të tij M. i cili pastaj ka shtënë me të njejtën armë në ajër, duke shtuar se, duke pas për bazë faktin se të gjithë anëtarët e dy familjeve kemi qenë afër njëri-tjetrit dhe akoma nuk e ka të qartë se si ka vepruar M., ku ka mundur që ti rrezikojë të gjithë personat e pranishëm. Po ashtu edhe dëshmitari M. G.1 ka dëshmuar përafërsisht ngjajshëm me dy të tjerët duke shtuar se pas shkakimit të zjarrit në shtallën e të akuzuarve ka ardhur deri te mosmarrëveshja mes tyre për shkak të dyshimit të M. për zjarrvënien dëshmitari Sh. ia ka marr automatikun nga dora të akuzuarit A. dhe ia ka dhënë M. i cili e ka zbrazur disa të shtëna mirëpo nuk është lënduar asnjë person.

Edhe dëshmitari P. G. ka deklaruar se pas shkakimit të zjarrit është krijuar një rrëmujë dhe kushërijt e të njejtit ishin fjalosur mes tyre në oborrin e shtëpisë së të akuzuarit M. dhe nga shtëpia e vetë dëshmitarit ka dëgjuar një të shtënë rafal të pushkës automatike e cila armë kur ky dëshmitar kishte shkuar në vendin e ngjarjes ishte hedhur në rrugë, dhe se në momentin e të shtënave i njëjti nuk ka qenë në vendin e ngjarjes.

Po ashtu gjykata nga procesverbali i dëshmisë-pronës i dt.26.07.2011 ku është përshkrimi i plotë i sendeve të marra në vendin e ngjarjes, vërtetohet fakti se në atë vend janë gjetur dhe sekuestruar arma AK-47 me nr.serik034831-86 si dhe 4 gëzhoja të kalibrit 7.62mm, si dhe në shtëpinë e të akuzuarit M. G. pas kontrollimit të shtëpisë janë gjetur dhe marrë një pushkë gjuetie e prodhimit turk me nr.serik121272, një kartelë VRC-03-30382, 19

fishekë të kalibrit 12 GA dhe një rrethatore për fishekë të cilat të akuzuarit i posedonin pa autorizim.

Po ashtu nga fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës vërtetohet qartë fakti i gjetjes së gëzhjojave në vendin e ngjarjes armët e sekuestruara, rrethoja me fishekë dhe vendi ku është gjetur automatiku AK-47.

Nisur nga këto rrethana të vërtetuara në seancat e shqyrtimit gjyqësor, gjykata ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarit M. G., manifestohen të gjitha elementet qenësore dhe tiparet e figures së veprave penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.1 të KPK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim, ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, dhe se i akuzuari këtë vepër penale e ka kryer me dashje duke qenë i vetëdijshëm se me veprimet e tij, gjegjësisht duke shtënë me automatik në një ambient ku ka edhe persona të tjerë me ç'rast shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve dhe pasurisë së të njejtëve. Po ashtu edhe në veprimet e të akuzuarit A. G. formësohen të gjitha elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së pasi që edhe ky i akuzuari këtë vepër penale e ka kryer me dashje duke qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij përkatësisht faktit se i njejtë i është kanosur të dëmtuarve nën kërcënimin e përdorimit të armës dhe se që të dy të akuzuarit po ashtu kanë qenë të vetëdijshëm se armët e zjarrit nuk mund ti mbajnë në posedim, shfrytëzim pa autorizim nga organet përkatëse. Gjithashtu gjykata vlerësoi edhe mbrojtjen e të akuzuarve dhe po ashtu vërtetoi se edhe nga deklaratimet e tyre në fakt të akuzuarit e kanë kundërshtuar vetëm cilësimin juridik të veprimeve të tyre ndërsaq i kanë pranuar të gjitha veprimet të cilat janë të përshkruara edhe në dispozitivin e precizuar të aktakuzës pranimin e të cilave veprime e kanë pohuar edhe mbrojtësit e tyre edhe në fjalën përfundimtare. Nga mbrojtja e të akuzuarit M. G. i njejtë asnjëherë nuk e ka mohuar faktin se e ka përdorë pushkën automatike dhe po ashtu ka shtënë me të njejtën në ajër dhe në prezencën e anëtarëve të dy familjeve, me çka vërtetohet në tërësi edhe përshkrimi faktik edhe cilësimi juridik i veprave penale për të cilat i njejtë është gjykuar dhe shpall fajtorë.

Ndërkaq i akuzuari A. G. në tërësi e ka mohuar se ka poseduar armë dhe se me të njejtën i është kanosur pa ofruar ndonjë prove konkrete dhe bindëse për gjykatën, dëshmi të së cilës gjykata do t'ia falte besimin dhe në të kundërtën ky pretendim mbrojtës i të akuzuarit është në kundërshtim të plotë me të gjitha provat tjera dhe dëshmitë e dëshmitarëve-të dëmtuarve të cilët të gjithë njësoj në mënyrë shumë bindëse kanë dëshmuar se armën fillimisht e ka poseduar i akuzuari A. G., i është kanosur të dëmtuarve dhe pastaj dëshmitari Sh. G. ka arritur që t'ia largojë nga dora dhe t'ia dorëzojë prindërve të të njejtit.

Ndërkaq sa i përket veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga ndjekja penale kundër të akuzuarve M. G. dhe A. G. për shkak se me ligjin për amnistinë nr.04L-2009 neni 7 par.1 pika 1.1 të këtij ligji, i cili ka hyrë në fuqi me dt.04.10.2013, kjo vepër penale lirohet nga ndjekja penale për shkak të përfshirjes në amnisti.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarit M. G. dhe A. G. i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante lehtësuese dhe rënduese,

në kuptim të nenit 64 të KPK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të dy të akuzuarit mori faktin se që të dytë deri më tani nuk kanë qenë të dënuar, gjendjen ekonomike ndërkaq rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj të njëjtve ua shqiptojë dënimin e kushtëzuar me burgim si dhe të akuzuarit M. G. edhe dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale, dhe se të njëjtit do të ndikoj në riedukimin dhe risocializimin e të akuzuarve, si dhe këto dënime do të ndikojnë edhe te të tjerët që të mos kryejnë vepra të tilla apo të ngjajshme penale, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 34 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, përkatësisht faktit se fillimisht janë akuzuar për shumë vepra të rënda penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale, ku në këtë çështje janë mbajtur shumë seanca gjyqësore si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarve, përkatësisht faktit se të njëjtit jetojnë në kushte të rënda ekonomike konform nenit 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë pasi që të dëmtuarit nuk kanë paraqitur asnjëri kurrfarë kërkesë për kompensim të dëmit, konform nenit 463 par.2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKRnr.651/13 të dt.05.11.2015

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.